




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01 Nr. 118-24148

Më: 15.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13, 58, 62.4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, kërkesës së Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë me nr.zyrtar 04/1688/ i dt.13/04/2016, neni 11 paragrafi 1, paragrafi 2 pika 2.3 dhe neni 3 të Rregullores Nr.01/2011 Për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të dt.21/03/2011, merr këtë:

V E N D I M

1.z.Erzen Vala, nga Gjakova, Komuna e Gjakovës, nga data 30.04.2016 i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të tejkalimit të afatit kohor të Vendimit 01 Nr.112-68547/2015 i dt.02/10/2015 si ushtrues i detyrës së zëvendës drejtorit të shkollës "Yll Morina" në Gjakovë.

2.Autorizohet shërbimi financiar pranë Drejtorisë për Arsim që të ndaloj pagesën e të ardhurave personale në lartësi të koeficientit të paraparë për pozitën e zëvendës drejtorit të shkollës.

A r s y e t i m

z.Erzen Vala, nga data 30/04/2016, i ndërpritet marrëdhënia e punës si ushtrues i detyrës së zëvendës drejtorit pranë kësaj shkolle për shkak tejkalimit të afatit kohor të Vendimit 01 Nr.112/68547/2015 i dt.02/10/2015.

Të ardhurat personale mujore për vendin e punës si ushtrues i detyrës së zëvendës drejtorit të ndërpritet nga data 30/04/2016.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet :

- z.Erzen Vala
- Shkollës "Yll Morina" në Gjakovë
- Drejtorisë së Arsimit
- Zyres së Personelit
- Shërbimit të pagesave
- Arkivit

KRYETARJA,

Znj.Mimoza Kusari Lila

